REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 01-060/01-0014642/20
Data Data 13.05.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës /Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Ne mbështetje të nenit 52, par.1 dhe 2, te Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 46 i Statutit të Komunës së Skenderajt nr./01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe nenit 12, par.1,2,3,4 të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve te përhershme në Komunë.

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa e cila do të mbahet me dt. 21.05.2020 me fillim në orën 11:00 në sallën e Kuvendit Skenderaj.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara;
4. Raporti Financiar i Realizimit të Buxhetit Komunal Janar-Mars 2020, me nr.02-052/01-00145565/20, i dt.12.05.2020(Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi),
5. Raport i Zyrës së Prokurimit për muajit Janar-Prill 2020, me nr.03-052/01-0014227/20, i dt.05.05.2020, (Raporton U.D e Shefes së Zyrës së Prokurimit znj. Hafseje Zejnullahu).
6. Të ndryshme.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO • KOMUNA E SKENDERAJIT • OPŠTINA SKENDERAJ • MUNICIPALITY SKENDERAJ • KUVENDI I KOMUNËS • SKUPŠTINA OPŠTINE

Kryesuesja e KK-së
znj. Fatbardha Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI I MBËLEDHJES KOMITETI PER POLITIK E FINANCAT I MBAJTUR MË DATËN: 23.03.2020

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Kryesuesja e Kuvendit pasi konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e kësaj mbledhjeje të KPF-se Skenderajt, propozon këtë:

R E N D D I T E

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara;
4. Propozim-Vendim për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për Qytetarët e Komunës së Skenderajt, me nr.02-352/05-0012737/20, i dt.10.03.2020, (Raporton Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari).
5. Raporti Përfundimtar Financiar i Realizimit të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2019, më nr.02-052/01-0012735/20,i dt.10.03.2020,(Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financave z.Kastriot Gashi).
6. Propozim-vendim për Emërtim dhe Ri-emërtim të (rrugëve, lagjeve, sheshe, urat dhe Institucionet), me nr. 08-020/01-0010236/20, i dt.25.02.2020, (Raporton Kryetari i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave z. Ibush Hetemi).
7. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej (15) vite në shfrytëzim toka e pa ndërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, ngastra nr.550-3 dhe ngastra nr.549-0 me sipërfaqe të tërësishme 7794 m2 "ELKOS GROUP" Person Juridik sipas konkursit (Ankandit Publik), me nr.01-463/01-0013420/20, i dt.23.03.2020, (Raporton Kryetari i komisionit për dhënien ne shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës z. Ramiz Shala).
8. Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt me person Fizik, me nr. 05.463/01-0013425/20, i dt.23.03.2020(Raporton Drejtori i DGJKP, z.Ramiz Shala).
9. Të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar të pranishëm i nderuar Kryetari i Komunës së Skenderajt z. Bekim Jashari, të nderuar anëtar KPF-së, të nderuar Drejtor të Drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm. Atëherë në salle janë 6 anëtarë të KPF-së, mungon Lavdie Geci me arsye sepse gjendet jashtë Kosovë ne shtetin e Gjermanisë e për shkak të situatës që po ndodh me virusin COVID-19 nuk mundet me udhëtua dhe duhet me ja be një shkresë MAPL-së, Para miratimit të rendit të ditës i kem dy pika shtesë nga Ramiz Shala:

-Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej (15) vite në shfrytëzim toka e pa ndërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, ngastra nr.550-3 dhe ngastra nr.549-0 me sipërfaqe të tërësishme 7794 m2 "ELKOS GROUP" Person Juridik sipas konkursit (Ankandit Publik), me nr.01-463/01-0013420/20, i dt.23.03.2020, (Raporton Kryetari i komisionit për dhënien ne shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës z. Ramiz Shala).

Ramiz Shala: Përshëndetje për të gjithë, ky propozim-vendim është ankand publik, si komision kemi përfundua procedurën ne afat ligjore sipas legjislacionit ne fuqi, të ankandit publike për dhënien e pronës ne shfrytëzim 1, deri në 15 vite , kemi pasur vetëm një ofertues, ofertuesi i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara ne ankand publike, dhe i ka premtuar edhe dy kritere shtesë, 1. Një depo për grumbullimin e pemëve dhe perimeve të qytetarëve të komunës së Skenderajt dhe 2. Ka me sponsorizua një klube të sportit ne komunën tone. Materialin e kini përpara dhe deri ne seancën e kuvendit kini kohe me lexua, dhe ju lusë qe të votoni e të hynë si pike shtesë e rendit të ditës.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin, fjalën ja kaloj Azem Gashi dhe Hysni Mehani;

Azem Gashi: Përshëndetje për të gjithë, Drejtor çfarë oferta ka dorëzuar ofertuesi në këtë ankand publik?

Hysni Mehani: Përshëndetje për të gjithë, çka konkretisht po premton ofertuesi, çka ka me bë në atë pronë ofertuesi, sa ka me punësua njerëz, a banë një sqarim ma shume?

Ramiz Shala: Ofertuesi ka ofruar këto: **1**.Deklarimi mbi vlerën investive të ofruare (vlera me e lartë e projektit për objektin afarist) nga ofertuesi është 975,932.12€.

2.Madhësia e objektit mbi bazën e metrave katrorë të shfrytëzuar, nga ofertuesi është 3,144.52 m2.

3.Deklarimi mbi vendet e lira të punës të cilat krijohen me realizimin e projektit (Numri me i lartë i vendeve të lira është), nga ofertuesi është 75 punëtor +/- 20%.

4.Paga mesatare për të punësuarit, nga ofertuesi është 479.00€.

5.Qarkullimi bankar në 5 viteve të fundit (qarkullimi me i madhe), nga ofertuesi është 1,537,386,431.6€.

6.Numri me i madhe i punëtorëve sipas deklarimeve në ATK, (për personat juridik) nga ofertuesi është 2,625 punëtor.

7. Deklaratat zotuese mbi afatet e realizimit të projektit, (koha me e shkurtër e realizimit) nga ofertuesi është 90 ditë pune.

8.Projekti ideor i objektit, e ka dorëzuar ofertuesi qysh doket ne fotografi.

Qiraja për këtë objekt qe ka me u ndërtua nga ofertuesi "ELKOS GROUP" ka me qenë 1257€ ne muaj qe ka me ja paguar Komunës se Skenderajt. ofertuesi i ka paguar edhe 20,000€ për pjesëmarrje ne ankand publikë.

Kryesuesja: Faleminderit, dikush tjetër nëse nuk ka, konstatojmë me (6)vota për, (0)kundër, (0)abstenim, futet si pike shtesë Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej (15) vite në shfrytëzim toka e pa ndërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt. Vazhdojmë me:

-Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt me person Fizik, me nr. 05.463/01-0013425/20, i dt.23.03.2020, (Raporton Drejtori i DGJKP, z. Ramiz Shala).

Ramiz Shala: Ky Propozim-Vendim ka të bëjë për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt me person Fizik, është fjala për pronën e komunën e Skenderajt me nr.226-5 ZK Skenderaj me sipërfaqe prej 1034 m2, me kulturë kullose klasë 3 vend i quajtur fshat pronësi e komunës së Skenderajt, kemi be marrëveshje me pronarin fizik Emin Murtezaj për këmbimin e pronës me ngastër nr.154-1, ngastër nr.203-6, ngastër nr.232-3 dhe nr. 155-4 ZK Skenderaj me sipërfaqe prej 1034m2 me kulturë kullose klasë 3 vendi i quajtur fshat. Klasa e tokës është e njëjte vetëm po e bëjmë këmbimin për lidhjen e poligonit sportiv qe ka mbet në gjysmë.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin Azem Gashi dhe Ilir Ejupi;

Azem Gashi: Drejtor, a mundesh me ma shpjegua se nuk e pata te qartë cilën pjesë keni me ja dhen personit ne fjalë ?

Ilir Ejupi: Drejtor the se klasa e tokës është e njëjtë, po në bazë të kësaj marrëveshje që e keni bë me personin fizik Emin Murtezaj ngastra nr. 226-10 me kulture are e klasës 1, dhe ngastra nr.154-1me kulturë kullos klasa 3, d.m.th. po bëjnë fjalë për të njëjtën klasë të tokës a banë sqarim drejtor?
Ramiz Shala: Në të dy rastet klasa e tokës është e njëjtë, vetëm emërtimi në kadastër është i ndryshëm, po vlera e tregut dhe në bazë të planit rregullues është i njëjtë po në duhet për më i dhënë qasje poligonit sportiv qe ka mbet ne gjysmë.
Kryesuesja: Faleminderit, e mbyllim debatin për këtë pike, konstatojmë me (5)vota për, (0)kundër, (1)abstenim, futet si pike shtesë Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt me person fizik. Vazhdojmë me:
-Miratimin e Rendit të Ditës konstatojmë me (6)vota për, (0)kundër, (0)abstenim miratohet Rendi i Ditës, Vazhdojmë me:
-Shqyrtimin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hapë debatin nëse nuk ka konstatojmë me (6)vota për, (0)kundër, (0)abstenim miratohet Procesverbali nga Mbledhja e Kaluar. Vazhdojmë me:
-Propozim-Vendim për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për Qytetarët e Komunës së Skenderajt, me nr.02-352/05-0012737/20, i dt.10.03.2020, (Raporton Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari).
Kryetari i Komunës z.Bekim Jashari: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, Ky Propozim Vendim është për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetaret e Komunës së Skenderajt ka qenë 200€+10 tash e kemi rritë e kemi bë 210€+10 në raste transporti jashtë territorit të komunës së Skenderajt. Këto mjete janë parapa me u nda nga të hyrat vetanake për këtë vite, kurse për vitin e ardhshëm besoj qe i ndryshojmë ne buxhet qysh duhet.
Kryesuesja: Faleminderit Kryetar, e hapë debatin fjalën ja kaloj Azem Gashit dhe Hysni Mehani.
Azem Gashi: Kryetar po me intereson gjatë vitit 2019 sa ka pas shpenzime për varrime që janë bë në komunën e Skenderajt, a keni ndonjë statistika?
Hysni Mehani: Unë personalisht kam marrë pjesë në një varrim dhe në atë varrim me banë përshtypje dërrasat që ishin shumë të liga. Dhe dua me ditë kjo kontratë që nënshkruhet a është parapa edhe kualiteti i dërrasave, se pse janë ato dërrasa aq të ligura?
Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Të shpenzimet për varrim ne komunën e Skenderajt për vitin 2019 janë 40,745.00€ që janë bë pagesat. Për dërrasa në kontratë janë paraparë dërrasa normale nuk janë të cekëne se çfarë druri.
Kryesuesja: Faleminderit Kryetar, dikush tjetër nëse nuk ka, konstatojmë me (6)vota për, (0)kundër, (0)abstenim, Rekomandohet për kuvend, Propozim-Vendim për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për Qytetarët e Komunës së Skenderajt. Vazhdojmë;
-Raporti Përfundimtar Financiar i Realizimit të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2019, më nr.02-052/01-0012735/20,i dt.10.03.2020,(Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financave z. Kastriot Gashi).
-Kastriot Gashi: Përshëndetje për të gjithë, Buxheti i vitit 2019 nga të gjitha burimet financiare ka shënuar një rritje ne total prej 6.58% ne krahasim me vitin 2018, kurse shpenzimet në total tejkalojnë 3.63% të shpenzimeve për vitin 2018. Në vitin 2019 komuna ka tejkaluar planin e të hyrave vetanake komunale prej 65.61%. Komuna jonë ka pranuar buxhet edhe nga donatoret ne vlerë prej 141,890.00€nga Qeveria Zvicerane nga fondi i Përformancës. Gjithashtu ka përfitua 96,753.93€ nga huamarrja në kuadër të Ministrisë së Arsimit Drejtoria për Arsim. Komuna e Skenderajt është ballafaquar edhe me një borxh të bartur nga viti 2018 prej 404 mijë €, kjo si rezultat se borxhi i bartur për vitin 2017ishte 1,176.00€ gjatë vitit 2018 është paguar pjesa me e madhe e saj po prapë në vitin 2019 është bartur një borxhe prej 404 mijë €, kurse për vitin 2020 janë bartur vetëm 56 mijë €, obligimet te pa paguara për faktin një pjesë e madhe të obligimeve faturat janë ardhur pas dt. 24.12.2019 që ne atë kohë është mbyllur sistemi. Të hyrat e bartura nga viti 2019 për vitin 2020janë 750 mijë€, ndërsa obligimet e kontingjenteve të cilët llogariten konteste gjyqësore të citet komuna e Skenderajt mund të ketë humbje janë 1,131.00€ po kjo është një vlerë kontingjente qe ndryshon.
Kryesuesja: Faleminderit drejtor, e hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (6)vota për, (0)kundër, (0)abstenim rekomandohet për kuvend Raporti Përfundimtar Financiar i Realizimit të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2019, Vazhdojmë:

-Propozim-vendim për Emërtim dhe Ri-emërtim të (rrugëve, lagjeve, sheshe, urat dhe Institucionet), me nr. 08-020/01-0010236/20, i dt.25.02.2020, (Raporton Kryetari i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave z. Ibush Hetemi).

-Ibush Hetemi: Në emër të Kryetari i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave ne kemi ardhur ne përfundim për emërtim dhe riemërtim të rrugëve ne komunën e Skenderajt. Këtë propozim e kemi pas në rend dite ne seancën e kaluar po është shtyrë për seancën tjetër për arsye të disa kërkesave të disa anëtarëve. Në këtë seancë e kemi bë një sqarim për secilën kërkesës qe ju me pas ma të qartë rrethe këtyre rrugëve.

Kryesuesja: Faleminderit drejtor, e hapë debatin fjalën ja kaloj Azem Gashi, Dorarta Ndrejshaj:

Azem Gashi: Drejtor a keni pasur ndonje kërkesë-ankesë për rrugë mbas mbajtjes së seancës, p.sh një koleg i joni ka ankua rreth rrugës së tanishme "Nuhi Geci" të riemërohet me "Martiret Vojvoda" Laushë?

Dorarta Ndreshaj: Drejtor pse ka mungesë të emrave të gjinisë femërorë nëpër rrugë?

Ibush Hetemi: Po ka pasur qe të behën sqarime dhe të rruga ne fjalë "Nuhi Geci" nuk e kam hekur dhe nuk kemi të drejt me hekë këtë emër. Dorarta kjo çështje është shqetësim në tërë Kosovën edhe pse jemi të obliguar me respektuar gjininë femërorë edhe ne aspektin e emërtimin e rrugëve po ka mungesë, po ne komunën tonë janë 3 emra të rrugëve të gjinisë femërorë .

Kryesuesja: Faleminderit drejtor, dikush tjetër nëse nuk ka konstatojmë me (6)vota për, (0)kundër, (0)abstenim, Rekomandohet për kuvend Propozim-vendim për Emërtim dhe Ri-emërtim të (rrugëve, lagjeve, sheshe, urat dhe Institucionet). Vazhdojmë:

-Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej (15) vite në shfrytëzim toka e pa ndërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, ngastra nr.550-3 dhe ngastra nr.549-0 me sipërfaqe të tërësishme 7794 m2 "ELKOS GROUP" Person Juridik sipas konkursit (Ankandit Publik), me nr.01-463/01-0013420/20, i dt.23.03.2020, (Raporton Kryetari i komisionit për dhënien ne shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës z. Ramiz Shala).

Ramiz Shala: Materialin e keni para veti për këtë propozim vendim, krejt çka pata me bisedua, bisedova ne fillim të mbledhjes, qe done sqarim ende jam këtu, ju lusë me përkrah së është për të mirën e komunës së Skenderajt.

Kryesuesja: Faleminderit drejtor, e hapë debatin nëse nuk ka, konstatojmë me (6)vota për, (0)kundër, (0)abstenim, Rekomandohet për kuvend Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej (15) vite në shfrytëzim toka e pa ndërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, ngastra nr.550-3 dhe ngastra nr.549-0 me sipërfaqe të tërësishme 7794 m2 "ELKOS GROUP" Person Juridik sipas konkursit (Ankandit Publik). Vazhdojmë:

-Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt me person Fizik, me nr. 05.463/01-0013425/20, i dt.23.03.2020(Raporton Drejtori i DGJKP, z. Ramiz Shala).

Rmiz Shala: Edhe për këtë pike biseduam ne fillim qe doni sqarime shtesë jam këtu për përgjigje ju lush me përkrah.

Kryesuesja: Faleminderit drejtor, e hapë debatin nëse nuk ka, konstatojmë me (5)vota për, (0)kundër, (1)abstenim rekomandohet për kuvend Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt me person Fizik. Vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve fjalën ja kaloj:

Azem Gashi: Drejtorit të inspeksionit i kisha propozua qe ti dërgon inspektorat të një lokal ne lagjen 3 ne drejtim te Drenasin ne krah të djathtë qe aj lokal po benë gërdira me mbeturina qe po hedhe?

Hysni Mehani: 1. Propozoj qe materiali i kuvendit me u shtypë me kopje se është problem me debatua me llaptop ne foltore, e prej vendit nuk ka zgjerim ende.? 2. Kryetar Vjollca Ramadani ka bërë një propozim ne email dhe nuk kemi marrë asnjeri përgjigje pse Kryetar.? 3.Kryetar për furrat e bukës ta kam dërguar një sugjerim qe furrat mos me mbet pa mille se behet problem i madh nga qytetaret dhe nuk ka ke kthyer dhe as nuk ma ke konfirmuar emailin.? 4.Drejtoria e inspeksionit, drejtor kur i keni mbyllur të gjitha lokalet e tekstilit duhet me qenë i barabartë me i mbyllë tana, se jo me ja lanë dikujt hapur e dikujt me ja mbyllë, p.sh Vives me ja venë shiritin e QTA-ja me pas drejt me shitë tekstil, po bani i pa drejt drejtor.?

Arton Veliu: I nderuar Hysni Mehani, ne jemi të barabartë me krejt bizneset ne komunën e Skenderajt për këtë rast qe po thua unë nuk jam i informuar dhe duhet me na informua e ne si drejtori kishim marr masa ndëshkuese për biznesin në fjalë, sepse tekstili nuk guxon me punuar ne as një lokal në as një qeder tregtare përpos maketeve ushqimore.

Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Si kryetar i komunës të Skenderajt prej asaj dite qe e kam marruar pushtetin ne Skenderaj jam betuar se nuk do të bëjë dallime për asnjë biznes ne komunën e Skenderajt, vetëm nëse bëjnë pa dijeninë time, kanë me qenë të barabartë të gjithë.

Kryesuesja: Faleminderit dikush tjetër nëse nuk ka, me kaq e mbyllim debatin për këtë mbledhje shihmi ne mbledhjen e Kuvendit qe mbahet me 31.03.2020 ne ora 13;00 seanca do të mbahet pa pranimin e publikut.

Procesmbajtësi
Mujë Selmani

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA E KOSOVA • KOMUNA E SKENDERAJT • OPSTINA SKENDERAJ • KUVENDI I KOMUNES • SKUPSTINA OPSTINA • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

Kryesuesja e KK-së
znj.Fatbardha Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 02-052/01-0014565/20
Data Data 12-05-2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Gradonacelnika / Office of the Mayor

RAPORTI FINANCIAR

i realizimit të buxhetit Komunal

Janar – Mars 2020

Prill 2020

Permbajtja:

Raporti Financiar Janar-Mars 2020 3

1. Kërkesat për raportim 3

2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE 4

Tabela 1 ..... Error! Bookmark not defined.

4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-MARS 2020 7

5. SHPENZIMET BUXHETORE JANAR-MARS 2020 9

Vazhdim i tabelës 11

Tabela nr. 5 Projektet kapitale Janar-mars 2020 12

Raporti Financiar Janar-Mars 2020

1. Kërkesat për raportim

Raporti Financiar Komunal për periudhën Janar – Mars 2020, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e nenit 45 të Ligjit Nr.03/L-048"Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë" dhe statutit Komunal.

Raporti Financiar Komunal ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Buxheti i vitit 2020 karakterizohët me vonesa të konsiderueshme kohore për fillimin e ekzekutimit të tij . Dekretimi i tij nga Presidenti është publikuara në "GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 1 / 19 MARS 2020", dhe deri atëher është zbatuar neni 24 LMFPP për "Ndarjet buxhetore në mungesë të një Ligjit për Ndarjet Buxhetore" dmth është aplikuar 1/12 pjesë e buxhetit të viti të kaluar .

Gjithashtu përiudha janar-mars veqohet posaqerisht ne aktivitet për zbatimin e vendimeve nga Qeveria qendror në luftimin e pandemisë globale COVID-19 e cila menjëhere ka rezultuar edhe në ndërhyerjet buxhetore duke transferuar shumën emergjente prej 139,000.00€ në projektin specifik 00099 i cili shërben për menaxhimin e kësaj emergjence. Kështu, të gjitha shpenzimet qe ndodhin mbrenda kësaj emergjence sipas Udhëzimit lidhur me shpenzimet qe lidhen me situatën e pandemisë COVID-19 mund edhe të rimbursohen. Për herë të parë nga MF dhe Transfereve është planifikuar kategoria rezerva-meq ende nuk është funksionalizuar Ligji i pagave.

Ka vazhduar buxhetimi nga huamarrja përmes MASHT në nën-programet "Administrat qendrore dhe Investimet kapitale në Arsimin Parauniversitar" në kuadër të projektit "Reforma në Arsim" (Komponenta 1.3 e Ligjit për ratifikimin e kësaj marrëveshje të huasë) dhe për këtë qëllim kumunës sonë i janë ndarë mjete ne shumën prej 79,329.00€ [1]

[1] Nonëse në tabelat e buxhetit janë prezantuar vetem buxheti dhe alokimet aktuale nërkohë ne kemi konfirmimin e për mjetet në shumën 79,329.00.€

2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme".

Buxheti i aprovuar në shtator 2019 ka pësuar ndryshime ne kategoritë ekonomike duke shtuar edhe një kategori tjeter "Rezervat" kurse totali nuk ka ndryshuar ishte **14,950,500** € tani buxheti është shpërndarë ne gjashtë kategori ekonomike (Paga &shtesa, Mallra & shërbime, Komunali, Subvencione Kapitale dhe Rezerva).

- Paga&shtesa	7,824,425
- Mallra&sherbime	1,650,640
- Komunali	294,537
- Subvencione	300,000
- Shpenzime Kapitale	3,773,140 dhe
- Rezerva	1,107,758
Gjithsej	**14,950,500**

Të gjitha këto të dhëna së bashku me alokimet janar-mars 2020, shpenzimet për të njejten përiudhë, shpenzimet janar mars 2019, krahasimin ne mes të periudhës 2020 dhe 2019 dhe indeksit ne mes të alokimeve në dispozicion dhe shpenzimeve mund ti shihni ne tabelën nr.1 (Ekzekutimi i buxhetit)

3. RAPORTI I EKZEKUTIMIT TE BUXHETIT JANAR MARS 2020

Tabela 1.

RAPORTI I BUXHETIT DHE EKZEKUTIMIT TË TIJ : Janar- mars 2020

FONDET BURIMORE	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Alokimet	Shpenzimet (pagesat) 2020	Shpenzimet (pagesat) 2019	Indeksi 2020/2019	Progresi me alokimet
						4/5	4/3
0	1	2	3	4	5	6	7
GRANTI I PERGJITHSHËM	**13,422,486.00**	**13,641,108.53**	**4,122,361.32**	**2,320,318.64**	**2,199,810.16**	**105.48%**	**56.29%**
Pagat dhe Mëditjet	7,824,425.00	7,824,425.00	1,940,721.10	1,940,721.10	1,897,423.75	102%	100.00%
Mallrat dhe Shërbimet	1,588,040.00	1,727,040.00	794,020.00	197,249.86	196,613.27	100%	24.84%
Shërbimet Komunale	294,537.00	294,537.00	147,268.50	47,786.21	51,123.34	93%	32.45%
Subvencionet	-	20,000.00	488.74	488.74	22,463.30	2%	100.00%
Investimet Kapitale	2,607,726.00	2,667,348.53	1,239,862.98	134,072.73	32,186.50	417%	10.81%
Rezerva	1,107,758.00	1,107,758.00					
TË HYRAT VETANAKE Aktuale	**1,528,014.00**	**1,624,525.51**	**133,578.64**	**17,100.70**	**-**	**#DIV/0!**	**12.80%**
Pagat dhe Mëditjet	-	-				0%	0.00%
Mallrat dhe Shërbimet	62,600.00	62,600.00	14,578.45	252.70	-	#DIV/0!	1.73%
Shërbimet Komunale	-	-		-		0%	0.00%
Subvencionet	300,000.00	315,000.00	32,175.06	16,848.00	-	#DIV/0!	52.36%
Investimet Kapitale	1,165,414.00	1,246,925.51	86,825.13		-	#DIV/0!	0.00%
TË HYRAT E BARTURA	-	-	-	-	-	**#DIV/0!**	**#DIV/0!**
Pagat dhe Mëditjet						0%	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet						#DIV/0!	#DIV/0!
Shërbimet Komunale						0%	#DIV/0!
Subvencionet						0%	#DIV/0!
Investimet Kapitale						#DIV/0!	#DIV/0!
DONACIONET	-	**36,119.18**	**36,119.18**	-	-	**#DIV/0!**	**0.00%**
Pagat dhe Mëditjet						0%	0.00%
Mallrat dhe Shërbimet		1,696.63	1,696.63			#DIV/0!	0.00%
Shërbimet Komunale						0%	0.00%
Subvencionet						0%	0.00%
Investimet Kapitale	-	34,422.55	34,422.55			#DIV/0!	0.00%
HUAMARRJA E JASHTME	-	**38,850.00**	-	-	-	**#DIV/0!**	**#DIV/0!**
Pagat dhe Mëditjet						0%	0.00%
Mallrat dhe Shërbimet	-	38,850.00				0%	#DIV/0!
Shërbimet Komunale						0%	0.00%
Subvencionet						0%	0.00%
Investimet Kapitale	-					0%	#DIV/0!
GJITHSEJ KATEG. EKONOMIKE	**14,950,500.00**	**15,340,603.22**	**4,292,059.14**	**2,337,419.34**	**2,199,810.16**	**106.26%**	**54.46%**
Pagat dhe Mëditjet	7,824,425.00	7,824,425.00	1,940,721.10	1,940,721.10	1,897,423.75	102%	100.00%
Mallrat dhe Shërbimet	1,650,640.00	1,830,186.63	810,295.08	197,502.56	196,613.27	100%	24.37%
Shërbimet Komunale	294,537.00	294,537.00	147,268.50	47,786.21	51,123.34	93%	32.45%
Subvencionet	300,000.00	335,000.00	32,663.80	17,336.74	22,463.30	77%	53.08%
Investimet Kapitale	3,773,140.00	3,948,696.59	1,361,110.66	134,072.73	32,186.50	417%	9.85%
Rezerva	1,107,758.00	1,107,758.00	-	-	-		

Grafiku nr.1 Shpenzimet në krahasim me Alokimet Janar-Mars 2020



Tabela nr.2. Përqindja e kategorive ekonomike në pjesëmarrjen e buxhetit Komunal viti 2020

GJITHSEJ KATEG. EKONOMIKE	Shuma	Pjesmarrja %
Pagat dhe Mëditjet	7,824,425.00	52%
Mallrat dhe Shërbimet	1,650,640.00	11%
Shërbimet Komunale	294,537.00	2%
Subvencionet	300,000.00	2%
Investimet Kapitale	3,773,140.00	25%
Rezerva	1,107,758.00	7%

Nga te dhënat e prezentuara ne tabelën nr. 2 , mund të shihet se kategoria Paga dheMëditje merr pjesë me 52% te buxhetit te përgjithshem , mallrat dhe shërbimet 11%, komunalit 2%, subvencionet 2% dhe kategoria e rojekteve kapitale merr pjesë me 25% dhe rezerva 7% (përqinjet e rrumbullaksuara).

Tabela nr. 3 Përqindja e fondeve burimore në pjesëmarrjen e buxhetit të aprovuar komunal 2020

Burimet e Financimit	14,950,500.00	Pjesmarrja %
GRANTI I PERGJITHSHËM	13,422,486.00	90%
Të hyrat vetanake 2020	1,528,014.00	10%

3. TË HYRAT VETANAKE JANAR-MARS 2020

Përveç Grandeve të pranuara nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: atimin në pronë, gjobat e trafikut, taksa administrative për leje ndërtimi, shërbimet e kadastrave, taksa për regjistrimin e automjeteve etj. te cilat kanë rendësi te madhe për buxhetin e përgjithshëm komunal .

Ne tabelen e radhes nr.4 janë prezantuar të hyrat vetanake komunale dhe shiquar sipas kolonave, kolaona e parë tregon llojin e te hyrave vetanake, kolona e dytë kodin ekonomik te tyre, planifikimi vjetor dhe ai i periudhës janar mars jane kolonat 4 e 5, realizimi per periudhen raportuese te krahasuar me periudhën e njëjt te vitit 2019 kolona 6 e 7, përqindja e realizimit ne krahasim me planin dhe ne raport me vitin e kaluar kolona 8 e 9 dhe kolona nr. 10 perqindjes sipas strukturës së secilës kategore ne të hyrat e përgjithshem.

Ndonëse në krahasim me përiudhën e njëjt të vitit të kaluar inkasimi i të hyrave vetanake komunale direkte ishte 8.72% ma madhe se viti 2019, plani i inkasimit për përiudhë raportuese është përmbush vetem 35.86%.

Tabela nr. 4 Të hyrat vetanake komunale sipas Drejtorive:

Nr.	Përshkrimi	Kodi	Planifikimi		Realizimi		% e realizimit		Strukt.
			2020	i-iii/2020	i-iii/2020	i-iii/2019	6/5	6/7	kol. 6
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I	**Administrata dhe personeli**	**16323**	**61,790.00**	**15,447.50**	**11,753.25**	**15,641.75**	**76.09**	**75.14**	**7.65**
1	Çërtifikatë lindjeje	50013	6,320.00	1,580.00	795.50	1,375.50	50.35	57.83	0.52
2	Çërtifikatë kurorëzimi	50014	7,750.00	1,937.50	1,564.00	1,584.25	80.72	98.72	1.02
3	Çërtifikatë vdekjeje	50015	4,350.00	1,087.50	812.00	1,149.00	74.67	70.67	0.53
4	Çërtifiaktë – vërtetime të tjera ofiqarike	50016	41,220.00	10,305.00	8,161.75	11,053.00	79.20	73.84	5.31
5	Taksa administrative	50019	2,150.00	537.50	420.00	480.00	78.14	87.50	0.27
II	**Financë, Ekonomi e Zhvillim**	**17523**	**416,700.00**	**104,175.00**	**68,213.14**	**55,587.68**	**65.48**	**122.71**	**44.39**
1	Tatimi në pronë	40110	322,800.00	80,700.00	50,789.89	37,572.68	62.94	135.18	33.05
2	Taksa për regjistrimin e automjeteve	50001	78,850.00	19,712.50	13,673.25	16,370.00	69.36	83.53	8.90
3	Taksa për regjistrimin e trashigimisë – pronës	50011	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	-
4	Taksat për vërtetime dhe çërtifikata tjera	50019	2,530.00	632.50	700.00	835.00	110.67	83.83	0.46
5	Gjobat e biznesëve nga inspektorët financiarë	50104	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	-
6	Taksa komunale në biznes	50201	12,520.00	3,130.00	3,050.00	810.00	97.44	376.54	1.98
7	0	0	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	-
III	**Shërbimet Publike - inspeksioni**	**18023**	**9,850.00**	**2,462.50**	**10,305.16**	**1,633.97**	**418.48**	**630.68**	**6.71**
1	Taksa për leje parkingu	50008	420.00	105.00	20.00	60.00	19.05	33.33	0.01
2	Gjobat nga inspektorët komunal	50104	1,250.00	312.50	1,365.00	20.00	436.80	6,825.00	0.89
3	Gjobat mandatore - hudhja e mbeturinave	50114	450.00	112.50	445.00	-	395.56	#DIV/0!	0.29
4	Taksa për pranim teknik të lokaleve	50205	2,150.00	537.50	360.00	450.00	66.98	80.00	0.23
5	Te hyrat nga koncesionimi i tregut te gjelbert	50417	5,580.00	1,395.00	1,154.16	1,103.97	82.74	95.65	0.75
6	Parkingu Publik - Skenderaj	50008	-	-	6,961.00	-	#DIV/0!	-	4.53
IV	**Bujqësi dhe zhvillim rural**	**47023**	**20,800.00**	**5,200.00**	**121.00**	**56.00**	**2.33**	**216.07**	**0.08**
1	Nderrimi i destinimit te tokes	50012	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	-
2	Taksa tjera administrative per bujqesi	50016	8,350.00	2,087.50	121.00	56.00	5.80	216.07	0.08
3	Shfrytezimi i prones publike	50405	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	-
4	Participimet në bujqësi	50409	12,450.00	3,112.50	-	-	-	#DIV/0!	-
5	0	0	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	-
